

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

Në padinë e

ASC-10-0042

1. [REDACTED]
[REDACTED], Prishtinë

Paditësi

Përfaqësuar nga avokati [REDACTED], Prishtinë

Kundër

[REDACTED],
Ndërmarrje Shoqërore,
[REDACTED]

I Padituri

**Agjencia Kosovare e Mirëbesimit,
Përfaqësuar nga UNMIK-u, Komponenti TSS,**
Prishtinë

1. Ankuesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Adresa: Rr. Ilir Konushevci Nr.8, Prishtinë

2. Ankuesi

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancave vendimmarrëse të mbajtura më 26 gusht 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesa është e bazuar, pasi që aktvendimi i Trupit Gjykues në lëndën SCA-08-0032 datë 28 maj 2010 është anuluar. Trupi Gjykues – në një përbërje tjeter – është urdhëruar që të rigjykojë lëndën.**
- 2. Shpenzimet për procedurat ankimore nuk duhet të ngarkohen.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi është, duke iu referuar lëndës SCA-08-0032, duke kërkuar një ndalim të përkohshëm "me anë të së cilit i padituri [REDACTED], i padituri Agjencia Kosovare e Privatizimit, apo ndonjë pretendues tjeter eventual, të pengohet nga transferimi, detyrimi, posedimi i së njëjtës në mënyrë që të sigurohen kushtet ekzistuese të pronës së paluajtshme" duke potencuar më tutje numrin kadastral të regjistrimit të ngastrës në fjalë. Paditësi pretendon se në padinë e tij atij i është dhënë titullari i pronësisë mbi ngastrat që lidhen me 2 aktvendimet e Gjykatës Komunale të Prishtinës, që aktualisht ndërlidhen me ankesën në pritje për t'u zgjidhur pranë Trupit Gjykues. Paditësi më tutje pretendon se ai ka vërejtur se "përafërsisht një muaj më herët, mbi pronën e paluajtshme [REDACTED]" dikush ka shkarkuar sasi të dheut mbi sipërfaqen që ai më vonë e ka rrafshuar." Nga ky fakt i pretenduar dhe duke marrë në konsideratë "zgjatjen e procedurës" në padinë kryesore, ai thotë se rreziku i transferimit të pronë së patundshme që është subjekt i kësaj padie, është gati dhe se ndalimi i përkohshëm duhet të aprovohet.

Kërkesa e datës 18 maj 2010 është dorëzuar pranë DHPGJS-së më 19 maj 2010 me anë të urdhrit të Trupit Gjykues i është dorëzuar Ankuesve, duke u dhënë atyre të drejtën që "të ushtrojnë argumentet e tyre kundërshtuese jo më vonë se më 28 maj 2010."

Ankuesi i dytë në këtë moment kohor nuk ka qenë i përfshirë fare në padinë kryesore. Ankuesi i parë është përmendur në urdhër si "Ankuesi".

Të dy Ankuesit parashtruan deklaratat e tyre në lidhje me kërkesën e Paditësit brenda afatit kohor të caktuar nga DHPGJS. Të dytë e kanë kundërshtuar kërkesën, duke potencuar se kushtet e nevojshme për lëshimin e ndalimit të përkohshëm nuk janë plotësuar, në veçanti pasi që Paditësi nuk i ka ofruar DHPGJS-së dëshmi të besueshme që ai do të pësonte dëm, dëmtim apo humbje të pariparueshme në rast të mos lëshimit të ndalimit të përkohshëm.

Më 28 maj 2010 Trupi Gjykues i DHPGJS-së lëshoi aktvendimin e atakuar, duke lëshuar ndalimin e përkohshëm të kërkuar me përmbajtjen në vijim:

"1. Padituri në Padinë origjinale – [REDACTED], Ankuesi – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit – dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si de facto administratore e NSH-së, dhe/apo ndonjë entitet tjeter ndalohet nga ndërmarrja e ndonjë veprimi për shitjen apo ndryshimin e titullarit të pronësisë të parcelave kadastrale [REDACTED] në Prishtinë

2. Ndalimi i përkohshëm do të ngelet në fuqi deri në nxjerrjen e aktvendimit përfundimtar të Dhomës së Posaçme.

3. Në pajtim me Nenin 55.5 të UA të UNMIK-ut 2008/6 dhe Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 mund të ushtrohet një ankesë me shkrim kundër këtij aktvendimi pranë kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda 15 ditëve nga data e dërgimit të aktvendimit tek pala."

Trupi Gjykues brenda aktvendimit të vet të kundërshtuar ka argumentuar se kërkesa dhe padia origjinale do të shfaqnin një bazë *prima facie* për lëshimin e ndalimit të përkohshëm të kërkuar. Nga aktvendimet e Gjykatës Komunale të Prishtinës do të kishte një supozim ligjor në favor të së drejtave të pronësisë së Paditësit në lidhje me parcelat. Pasi që Paditësi, në opinion e Trupit Gjykues, "ka parashtruar pretendimet specifike për dëm të menjëherëshëm dhe të pariparueshëm" ai mund të pësonte në rast se ndokush do t'i shiste parcelat, kushtet e Nenit 55.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6 do të plotësoheshin dhe ndalimi do të lëshohej.

Ndalimi i është dorëzuar më 9 qershor 2010 Ankuesit të parë dhe më 8 qershor 2010 Ankuesit të dytë. Më 23 qershor 2010 të dy Ankuesit parashtruan ankesatë ndara pranë DHPGJS-së kundër ndalimit të përkohshëm.

Të dy ankesat argumentojnë se Aktvendimi i Trupit Gjykues nuk është në pajtim me Nenin 55 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Të dy Ankuesit pretendojnë se Paditësi nuk ka dëshmuar se dëmi, dëmtimi apo humbja e pariparueshme do të rezultonte në rast të mos lëshimit të ndalimit të përkohshëm

Arsyetimi Ligjor

Bazuar në Nenin 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave vendosi që të vazhdojë me pjesën verbale të procedurës.

Ankesat janë të pranueshme dhe të bazuara, pasi që vendimi duhet të anulohet dhe lënda duhet t'i nënshتروhet rigjykimit nga Trupi Gjykues.

Pranueshmëria:

Ankuesi i dytë, edhe pse nuk ka legjitimitet pasiv në lidhje me padinë në procedurën kryesore, k atë drejtën e parashtrimit të ankesës, pasi që ka pësuar nga vendimi i kundërshtuar.

Pasi që Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së veç se ka vendosur në lëndën ASC-09-0053 (dhe të tjera), Ankuesi i dytë, edhe pse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (PSSP) në sqarimin e datës 12 nëntor 2009 në lidhje me statusin ligjor të AKP-së në procedurat pranë DHPGJS-së theksoi qartë se përfaqësimi i NSH-së në parim është akoma nën përgjegjësinë e AKM-së, k atë drejtën të përfaqësojë NSH-të që faktikisht janë nën administrimin e saj. Kolegji i Ankesave në aktvendimin e sipërpërmendur ka arsyetuar si vijon:

"Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e themeluar në Nëntor 2002 me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar me anë të Rregullores 2005/18, ka përfunduar veprimtaritë e saja në qershor 2008. Veprimtaritë e saja, duke përfshirë edhe përfaqësimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) pranë Dhomës së Posaçme, janë marrë faktikisht nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)."

Duke marrë në konsideratë gjendjen faktike në vend në Kosovë pasi që AKM-ja nuk ushtron më detyrat dhe kompetencat e saj ashtu siç përcaktohet në Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar, dhe më tutje duke marrë në konsideratë se ekziston nevoja e menjëherëshe që NSH-të të përfaqësohen para Dhomë së Posaçme, dhe duke marrë në konsideratë si një parim bazë sistemet ligjore që sipas sundimit të ligjit nuk lejojnë vakuumet ligjore, përfaqësimi i NSH-ve nga AKP-ja për momentin duhet të pranohet.”

Ky arsyetim në mënyrë të natyrshme nuk aplikohet në ato lëndë, ku AKM-ja (e përfaqësuar nga UNMIK-u) është akoma aktive dhe ushtron përgjegjësitë e veta (shih ASC-09-0025), që është rasti këtu.

Sipas Nenit 29.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 (“Rregullorja e AKM-së”), AKM-ja (ashtu siç është definuar në Nenin 3 të Rregullores së AKM-së) ka të drejtë ligjore, që të kërkojë çfarëdo të drejtash, për një “Ndërmarrje” (NSH apo NP; shih Neni 5 i Rregullores së AKM-së) në gjykatën kompetente, në emër të asaj ndërmarrjeje. Neni 29.3 i Rregullores së AKM-së, për më tepër thotë: “Kurdoherë që procedimi ligjor është në pritje të zgjidhjes së një çështjeje, në emër të një ndërmarrjeje ose kundër saj, Agjencia, në çdo kohë, mund ta njoftojë gjykatën kompetente, se ajo do të veprojë si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes në fjalë, me kusht që ajo të veprojë si përfaqësues ligjor i vetëm një ndërmarrjeje, në procedimin kur ka më shumë se një ndërmarrje ose korporatë.”

Si pasojë, parimisht është vetëm në zgjedhjen e AKM-së që të marrë përfaqësimin e ndonjë NSH-je në procedurën para DHPGJS-së, nëse vetëm në NSH është e përfshirë.

Ankuesi AKP, megjithatë, pretendon se është trashëgimtare ligjore e AKM-së, e cila ka pushuar së ekzistuari, si pasojë duke çuar në përfundimin se AKP-ja duke i pretenduar të drejtat e ish AKM-së në fund do të përfundonte si përfaqësuese e NSH-së.

Kjo nuk është në rregull. Në fakt, Kolegji I Ankesave ndjek sqarimin e SPPS-së të datës 12 nëntor 2009 në lidhje me Nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, duke iu përgjigjur një kërkese të Kryetarit të DHPGJS-së të datës 26 tetor 2009:

Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 (Rregullorja e AKM-së), e ndryshuar, është promulguar nga PSSP në pajtim kompetencat që i janë dhënë atij me anë te

Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244 (1999). Rregulloret e UNMIK-ut mund të shfuqizohen apo ndryshohen nga PSSP-ja si vetë legjislatori, me anë të ndonjë rregullore tjetër. Rreg e AKM-së, e ndryshuar, ka ngelur e paprekur nga PSSP. Është akoma në fuqi, ashtu siç është edhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1244 (1999)

Ligjo Nr. 03/L-067 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("Ligji i ALP-së") i adaptuar nga Kuvendi i Kosovës, pa u promulguar nga PSSP nuk mund të shfuqizojë apo të zëvendësojë Rregulloren e AKM-së. Në veçanti, nuk mund të përfundojë ekzistencën ligjore të AKM-së si një agjenci me personalitet të plotë juridik ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren të AKM-së. AKP-ja nuk është themeluar mbi bazat e ligjit të aplikueshëm në Kosovë në pajtim me Rezolutën 1244. Në veçanti, Neni 1 i Ligjit të AKP-së ("Themelimi dhe Statusi Ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit") i cili thotë se AKP-ja është themeluar si trashëgimtare e AKM-së, nuk mund ét konsiderohet si ligj i aplikueshëm nën Rezolutën 1244, prandaj AKP-ja nuk mund të trajtohet si trashëgimtare ligjore e AKM-së, edhe pse në anën tjetër mund të kryej detyra dhe përgjegjësi të AKM-së ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren e AKM-së.

Gjithashtu pezullimi përkohshëm i veprimtarive të AKM-së nga UNMIK ED 2008/34 nuk mbështet përfundimin e saj të trashëgimisë ligjore: Në fakt pezullimi (i vetëm) i përkohshëm e nënviron edhe më shumë se statusi ligjor i AKM-së nuk duhet të pengohet, por të ruhet në rast se bëhet sërisht operativ.

Megjithëse, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së në jurisprudencën e vetë ka marrë në konsideratë "dukjen" faktike të AKP-së, dhe ka vendosur për disa raste (shih ASC-09-0108, ASC-09-0038, ASC-09-0053, ASC-09-0083 et al):

"AKM-ja, e themeluar në nëntor 2002 me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, e ndryshuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18, ka përfunduar veprimtaritë e saj, duke përfshirë edhe përfaqësimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) pranë DHPGJS-së, janë marrë faktikisht në kompetencë nga AKP-ja.

Duke marrë në konsideratë gjendjen faktike në vend në Kosovë, duke qenë se AKM-ja më nuk i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj ashtu siç është definuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar, më tutje duke marrë në konsideratë nevojën e menjëherëshme që NSH-të të përfaqësohen siç duhet para DHPGJS-së, dhe duke konsideruar se si parim themelor sistemet ligjore që ndjekin sundimin e ligjit nuk lejojnë vakuumet ligjore, përfaqësimi i NSH-ve nga AKP-ja për momentin kohor, do të jetë i pranueshëm.

Në situatat kur AKM-ja nuk e ka marrë përfaqësimin e NSH-ve, AKP-së i është lejuar të tejkalojë vakuumin ligjor të mungesës (faktike) të AKM-së si përfaqësuese e duhur.

Megjithatë, për rastin në fjalë, AKM-ja në mënyrë eksplikite ka marrë vendimin që të përfaqësojë NSH-në e përfshirë, duke aplikuar kompetencat e saj ashtu siç është përcaktuar me anë të Rregullores së AKM-së. Në një situatë të tillë nuk ka vakuum ligjor që të plotësohet, dhe asnjë hapësirë për ndonjë përfaqësim nga AKP-ja. AKP-ja mund të përfaqësojë një NSH pranë DHPGJS-së, nëse AKM-ja nuk ushtron të drejtën e saj për ta bërë atë, apo nëse AKM-ja ligjërisht nuk ka të drejtë ta bëjë atë (në rastet me konflikt siç është përkufizuar në Nenin 29.3 të Rregullores së AKM-së).

Prandaj, nuk ka asnjë arsyë të vlefshme që AKP-ja të përfshihet në këtë lëndë. Nuk ka asgjë brenda shkresës së lëndës që përcakton se AKP-ja është, siç Trupi Gjykues mendon, "*de facto administratori*" i të Paditurit, çka mund të sqarohet, nëse nga pikëpamja e Trupit Gjykues është e nevojshme.

Pos kësaj, pasi që kjo Gjykatë e ka përcaktuar më përrpara (ASC-09-0108, aktvendimi i datës 09 shkurt 2010) nuk ka bazë ligjore që të përfshihet AKP-ja në ndonjë padi nëse padia ndërlidhet vetëm me lidhjet ligjore të një NSH-je me një person tjetër ligjor apo fizik, pasi që AKP-ja edhe për shkak të mandatit të saj i paraparë me anë të Ligjit të AKP-së (dhe vetëm në ato lëndë ku ajo zgjedh të veprojë ashtu) "vetëm" vepron si përfaqësuese, që do të thotë vetëm në emër të NSH-ve në procedura gjyqësore, që aspak nuk ndikon në legjimitetin aktiv dhe/apo integritetin ligjor të NSH-ve. Nëse, sikur këtu, ku jo vetëm Paditësi pretendon se AKP-ja ka ndonjë *legitimatio passiva*, por vetëm, brenda një

renditjeje të hapur, emëron AKP-në me "çfarëdo pretenduesi tjetër eventual" si adresues të mundshëm për ndalimin e përkohshëm të kërkuar, pasi që Gjykata nuk ka kërkuar asnje sqarim nga Paditësi se kënd dëshiron të padisë si të Paditur, nuk ka ndonjë arsy që të përfshihet në procedurë. Aktvendimi i Trupit Gjykues për të dorëzuar kërkesën e Ankuesit të dytë nuk ka ndonjë efekt ligjor në procedurat para Trupit Gjykues. Pa pasur nevojë që të jepen sqarime të mëtutjeshme, për shkak të arsyetimit të dhënë më lart në lidhje me pozitën e AKP-së në lëndët ku AKM-ja ekzekuton përgjegjësitë e veta, Kolegji i Ankesave është në pozitë që përfundimisht të vendosë mbi pozitën e AKP-së – në procedurën e përsëritur të shkallës së parë.

Megjithatë, pasi që Ankuesi i dytë me anë të aktvendimit të kundërshtuar është urdhëruar nga Trupi Gjykues t'i shmanget çfarëdo veprimi që ndikon në statusin ligjor të parcelave në fjalë, AKP-ja ka pësuar dëm nga ky vendim, pasi që dukshëm lidhet me punët e veta ligjore, dhe kështu ka të drejtën që të parashtrojë ankesë kundër tij.

Ankuesi i parë, gjendja procedurale e së cilit brenda procedurave në lidhje me ndalimin e përkohshëm është i paqartë – është emëruar si "Ankuesi" brenda procedurave të shkallës së parë -, gjithashtu pëson dëm, pasi që aktvendimi gjithashtu urdhëron atë ta ndalojë nga çdo veprim që ndikon në statusin ligjor të tokës në fjalë. Prandaj sa i përket gjendjes procedurale të AKM-së duhet të sqarohet qartë se, Paditësi në kërkesën e tij për ndalim të përkohshëm nuk ka përcaktuar se AKM-ja si e Paditur në këtë kërkesë, nuk është në zgjedhjen e gjykatës që të shtojë dikë si një palë në procedurë kur nuk ka arsyе për një veprim të tillë sipas Nenit 5.1 lit d) apo 5.2 lit. e, e Rregullores së UNMIK-ut 2008/4. Pasi që Trupi Gjykues nuk ka dhënë ndonjë arsyë për përfshirjen e AKM-së si një palë në procedurë në lidhje me kërkesën për ndalim të përkohshëm, Kolegji i Ankesave nuk është për momentin kohor në gjendje që të gjykojë mbi vlefshmërinë e aktit procedural. Në parim i takon ekskluzivisht Paditësit se kundër kujt dëshiron të ndërmarrë një veprim, por jo gjykatës (ASC-10-0022 et al.)

Meritat e ankesës:

Ankesat janë të bazuara, pasi që aktvendimi duhet të anulohet dhe Trupi Gjykues – në një përbërje tjetër (Neni 65 lit.c i UA të UNMIK-ut 2008/6) – duhet të urdhërojë që të rigjykohet lënda:

Kriteri për lëshimin e një ndalimi të përkohshëm lind nga Neni 55.1 i UA të UNMIK-ut 2008/6: pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për masë të përkohshme. Këto kritere janë dhënë në atë mënyrë që nëse njëra nga to mungon atëherë kërkesa duhet të refuzohet.

Paditësi nuk ka dhënë asnjë dëshmi që të mbështesë kërkesën e tij, edhe pse pretendimet ishin kontestuar nga Ankuesit. Ai nuk ka përcaktuar aspak se në një moment kohor të drejtat e tij të pretenduar për pronën kanë qenë apo do të rrezikoheshin nga ndonjë veprim specifik i Ankuesve apo i të Paditurit që ai dëshiron ta sheh të ndaluar nga ndalimi i përkohshëm për të cilin ai ka aplikuar. Ai nuk ka prezantuar – dhe as nuk ka pretenduar – asnjë indikacion, për shembull për një likuidim të planifikuar apo privatizim të të Paditurit, e që do të mund të kuptohej si një ndryshim i rëndësishëm në strukturën e të Paditurit, e që do të mund të çonte drejt rrezikut të pronës së tij dhe kështu drejt nevojës për të lëshuar një ndalim të përkohshëm. Duhet të theksohet se në faktin e pretenduar që "*dikush (kush?) ka derdhur sasi të dheut në sipërfaqen të cilën ai e kishte rrafshuar*" nuk është fakt i mjaftueshëm që mund të kuptohej si indikator i vetëm për ndonjë përpjekje për të transferuar pronën. Argumentimi i Trupit Gjykues nuk mund të ndiqet që kërkesa dhe padia e nënvizuar do të tregonin një bazë *prima facie* për lëshimin e ndalimit të përkohshëm, respektivisht që prej aktvendimeve të Gjykatës Komunale të Prishtinës do të rezultonte supozimi ligjor për të drejtat e pronësisë së Paditësit dhe kështu Paditësi do të kishte "*përcaktuar pretendime specifike në lidhje me dëmin e menjëhershëm dhe të pariparueshëm*" që ai do të pësonte në rast se ndokush do të shiste parcelat.

Pasi që aktvendimet e Gjykatës Komunale të Prishtinës – që për shkak të ankesës që është akoma në pritje për t'u zgjidhur, të paktën formalisht janë

akoma në fuqi, - mund të lëshojë dëshmi *prima facie* në lidhje me të drejtat pronësore të Paditësit. Por nga këto të drejta të pronësisë në lidhje me pretendimet se "dikush ka derdhur sasi të dheut në sipërfaqen të cilën ai e kishte rrafshuar" nuk ka lidhje logjike me ndonjë supozim se një "entitet"- i pa specifikuar – mund të planifikojë që të shes parcelat. Kjo nuk të shpie drejt konkluzionit se të drejtat e pronësisë së paditësit janë në rrezik të menjëherëshëm. Në veçanti, nuk mund të shihet se sa gjatë i Padituri rrezikon ndonjë të drejtë të Paditësit. Trupi Gjykues nuk ka shpjeguar se pse "padia themelore" tregon një bazë *prima facie* për lëshimin e ndalimit. Arsyetimi ligjor i një aktvendimi duhet të përbajë nënkuptimin e fakteve brenda një dispozite apo definicioni të dhënë. Përsëritja e pastër e definicionit apo dispozitës pa sqaruar se cilat fakte të një lënde plotësojnë kushtet e paraqitura, nuk plotëson këtë kriter.

Prandaj, Trupi Gjykues duhet të sqarojë, duke pyetur Paditësin, se çfarë fakte mund të paraqes para DHPGJS-së që mund të jenë legjitime për të mbështetur kërkesën e tij dhe për të vërtetuar që i Padituri (i përfaqësuar nga AKM) është duke planifikuar të ndërmarrë ndonjë hap drejt një ndryshimi në marrëdhëni aktuale pronësore në lidhje me parcelat e tokës.

Me përjashtim të konsideratave të sipërpërmendura, humbja apo dëmi i mundshëm duhet të jetë i pariparueshëm dhe ndalimi i përkohshëm i kërkuar duhet të jetë masa e duhur dhe proporcionale për të shmangur një dëm apo humbje të tillë. Për lëndën në fjalë, nuk ekzistojnë fakte që do të lejonin gjykatën të vijë në atë përfundim në lidhje me shtrirjen e Nr. 2 të dizpositivit të aktvendimit të kundërshtuar.

Nëse do të kishte ndonjë arsyе për lëshimin e një ndalimi të përkohshëm – që Trupi Gjykues do të duhej të sqarojë dhe të vendosë varësish nga faktet që do të mblidhen dhe vlerësohen nga Trupi Gjykues në rigjykim – Trupi Gjykues duhet të marrë në konsideratë nëse ndalimi i përkohshëm duhet të përfshijë një urdhër ndaj Zyrës Kadastrale për të shtuar një shënim "*lis pendens*" për regjistruesin kadastral, duke siguruar që ndonjë pronar i mundshëm në të ardhmen, i cili pretendon të ketë fituar pretendimin e tij mbi pronën pas lëshimit të ndalimit të përkohshëm, do të duhej të pranonte rezultatin e gjykimit kryesor kundër tij.

Kjo në veçanti do të vendoste një barrë më të lehtë mbi të Paditurin, pasi që ai akoma do të kishte mundësinë të përdorte pronën e tij reale – te pretenduar – duke ia shitur atë dikujt nën kushtin dhe rrezikun se ai mund të dal se nuk është pronari ligjor, ndërsa rreziku i kërkuesit për të humbur pronën e pretenduar me anë të një veprimi të tillë do të eliminohej. Në asnjë rast nuk mund të jetë e drejtë të obligohet “dhe/apo ndonjë entitet tjeter” që të pengohet nga ndonjë veprim tjeter. Obligimet mund të imponohen palëve në padi.

I takon Trupit Gjykues që të kërkojë nga Paditësi më shumë fakte për të mbështetur kërkësën e tij, dhe të informojë Paditësin në lidhje me defektet e dukshme të kërkësës së tij në lidhje me kriterin e sipershënuar që të përfshihet në një kërkësë për ndalim të përkohshëm.

Udhëzime për parashtrimin e një ankesë:

Pika 4 e aktvendimit kundër së cilit është parashtruar ankesë është e pasaktë dhe duhet të eliminohet pa zëvendësim, pasi që udhëzimet për parashtrimin e një ankesë duke cituar ligjin pa ndonjë zgjedhje nga ana e gjykatës, nuk janë vendime dhe si të tilla nuk përfshihen në dispozitiv. Një informacion i tillë mund të jepet brenda arsyetimit ligjor apo – në të kundërtën – të bashkëngjitet vetëm në një aktvendim, por nuk mund të jetë pjesë e tij (shih ASC-09-0108, ASC-10-0023, ASC-10-0036, ASC-09-0075 et al).

Si shtesë, këshilla që është dhënë nga Trupi Gjykues për lëndën në fjalë është po ashtu e pasaktë dhe mund të bazohet në një keqinterpretim të ligjit. Afati kohor për të parashtruar në ankesë kundër çfarëdo aktvendimi të Trupit Gjykues është 30 ditë, ashtu siç është paraparë në mënyrë eksplikite me anë të Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4. Neni 13.2 i UA të UNMIK-ut 2008/6, ashtu siç është kërkuar nga Trupi Gjykues si një bazë ligjore për shkurtimin e afatit kohor për ankesë në 15 ditë, nuk i jep një zgjedhje të tillë gjykatës. Formulimi i saj i jep zgjedhjen për të shkurtuar afatin kohor në 15 ditë të “*kohës në pajtim me çfarëdo Aktvendimi të gjykatës*”, por jo për afatet kohore për parashtrimin e këshille ligjore siç është parashkruar në ligj. Për më tepër, Trupi Gjykues, i cili nuk ka argumentuar se ka aplikuar këtë dispozitë me anë të analogjisë (pasi që do të shkelte të drejtat e palëve të dhënë me ligj, pa ndonjë hapësirë ligjore për t'u plotësuar, do të ishte e pasaktë), nuk ka marrë në konsideratë parimin ligjor,

që një normë më e ulët (pasi që dispozitat e UA-së janë në lidhje me ato të Rregullores) asnjëherë nuk mund t'ia kalojnë një norme më të lartë (në këtë lëndë: Neni 9.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4). Ky parim ligjor veçse është pjesë e ligjit të lëndëve të DHPGJS-së, në veçanti në lidhje me Nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.

Aspektet që mbasë duhet të sqarohen në shkallën e parë:

Trupi Gjykues, në një përbërje tjetër, do të duhej para lëshimit të një vendimi të ri, të sqarojë – në mesin e aspekteve tjera të përmendura më sipër – edhe aspektet si më poshtë:

Nga rr Ethanat faktike dhe procedurale të aktvendimit kundër së cilit është parashtruar ankesë, nuk është e qartë nëse kërkesa për ndalim të përkohshëm është parashtruar me një padi në pritje për t'u zgjidhur ne mes të personave të emëruar si palë në aktvendim. Kjo duhet të sqarohet dhe të theksohet në mënyrë eksplikite. Gjithashtu, pyetja se pse Ankuesi i parë e ka pasur tanimë rolin procedural të Ankuesin brenda procedurës para Trupit Gjykues, nuk e gjen përgjigjen e vetë nga vendimi i kundërshtuar dhe prandaj duhet të trajtohen nga një aktvendim i ri i mundshëm.

Trupi Gjykues duhet të sqarojë nëse AKM-ja është faktikisht një palë në procedurë apo nëse vetëm përfaqëson të Paditurin.

Kthimi i lëndës në shkallën e parë:

Që t'ju jepet palëve mundësia të dëgjohen nga dy shkallët (shih ASC-09-0013), lënda duhet të kthehet për rigjykim në një përbërje tjetër të Trupit Gjykues, Neni 65 lit c UA e UNMIK-ut 2008/6.

Neni 65 lit c UA e UNMIK-ut 2008/6 parashev zgjedhjen e Kolegjit të Ankesave për të urdhëruar rigjyimin e lëndës para një Trupi tjetër Gjykues. Kjo zgjedhje nuk është e pakufizuar, ashtu siç është çdo zgjedhje e një gjyqtari në një sistem ligjor që drejtohet nga sundimi i ligjit, porse i nënshtrohet kushteve të caktuara të cilat duhet të definohen mbi baza lëndore për të krijuar një praktikë gjyqësore

të parashikuar. Përcaktimi i kufijve të zgjedhjes së lirë , *ratio legis* i dispozitës duhet të merret në konsideratë. Një ndër arsyet e kësaj dispozite (bashkë me mungesën e dukshme dhe të dëshmuar të paanësisë dhe asaj të specializuar për një tjetër Trup Gjykues për çështjen për të cilën duhet të vendoset) është që legjislatori ka marrë në konsideratë shqetësimet e mundshme të palëve të lëndës që do të rigjykohet në lidhje me paanësinë e gjyqtarëve (shih ASC-09-0013). Pandonjë paragjykim për paanësinë aktuale të gjyqtarëve, që si parim mund të konsiderohet edhe në lëndët, të cilat duhet të rigjykohen, perceptimi i palëve mund të jetë i ndryshëm – me arsyetë mira subjektive. Veçanërisht kur për një lëndë është vendosur mbi meritat, perceptimi i palëve në lidhje me paanësinë e gjyqtarëve mund të jetë që besimi i tyre në paanësinë e gjyqtarëve është i nënvlérësuar, pasi që gjyqtarët veçse e kanë shprehur pozitën përfundimtare në lëndën e tyre. Natyrisht kjo nuk mund të jetë kështu çdo herë kur Kolegji i Ankesave urdhëron rigjykimin e një lënde bazuar në një opinion ligjor që dallon në një pikë apo një tjetër nga ajo e Trupit Gjykues, por perceptimi i një mungese potenciale të paanësisë bëhet akoma më i fuqishëm në rast se Kolegji i Ankesave, në vendimin e vet ku urdhërohet rigjykimi i lëndës, dallon shumë nga opinioni ligjor i Trupit Gjykues. Prandaj, duke marrë në konsideratë specifikat e lëndës në fjalë, lënda duhet të dëgjohet nga një përbërje tjetër e Trupit Gjykues (për shkak të mungesës së gjyqtarëve [si ndërkombëtar ashtu edhe vendorë], DHPGJS nuk përfshinë Trupa Gjykues të tjerë, por vetëm përbërje tjera të Trupit Gjykues).

Shpenzimet:

Pasi që lënda duhet të dëgjohet prapë *ex principio* nga një përbërje tjetër e Trupit Gjykues, Kolegji i Ankesave, duke aplikuar parimin ligjor të Nenit 54 të Ligjit mbi Tarifat, 1987, e konsideron se është e arsyeshme që të mos imponohen shpenzimet e procedurave ankimore si dhe ato të procedurave të shkallës së parë për asnjëren palë.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues
EULEX

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar

EULEX

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare
EULEX

Tobias Lapke, Regjistrues
EULEX